



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:061883
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05742801

K.Dh.Sh. II.nr. 37/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija-Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “N.P.SH. “Trofta e Drinit” me numër unik identifikues 810753328 e shndërruar në SH.P.K., “Trofta e Drinit” me numër unik identifikues 811855941, me seli në Pejë, Fshati Radac, p.n., kundër debitorit Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” me seli në Pejë, rruga “UÇK”- së, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1708/22 të datës 30.10.2023, me datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” me seli në Pejë, rruga “UÇK”- së, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1708/22 të datës 30.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1708/22 të datës 30.10.2023, në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” me seli në Pejë, dhe ka anuluar pjesërisht Urdhrin P.nr.14/22 i datës 23.02.2022 i lejuar nga Përmbartuesi

Privat Shpend Ahmetaj, sa i përket shumës prej 267.00 € (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro) sipas Faturës nr.182 të datës 03.07.2019; Faturës nr.212 të datës 06.08.2019; Faturës nr.220 të datës 17.08.2019; Faturës nr.15 të datës 19.01.2020 dhe në këtë pjesë procedura përbarimore është përfunduar. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” me seli në Pejë, dhe ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përbarimor P.nr.14/22 të datës 23.02.2022 i lejuar nga Përbaruesi Privat Shpend Ahmetaj për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,280.30 € (dy mijë e dyqind e tetëdhjetë euro e tridhjetë cent).

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1708/22 të datës 30.10.2023.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitë kreditori edhe pse të njejtën e ka pranuar me datën 11.12.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “N.P.SH. “Trofta e Drinit” ka paraqitur propozim për përbarim në bazë të dokumenteve të besueshme Faturës nr.6 të datës 12.01.2019; Faturës nr.23 të datës 08.02.2019; Faturës nr.32 të datës 15.02.2019; Faturës nr.33 të datës 19.02.2019; Faturës nr.48 të datës 06.03.2019; Faturës nr.65 të datës 21.03.2019; Faturës nr.69 të datës 24.03.2019; Faturës nr. 72 të datës 27.03.2019; Faturës nr.108 të datës 27.04.2019; Faturës nr. 109 të datës 27.04.2019; Faturës nr.120 të datës 07.05.2019; Faturës nr. 126 të datës 11.05.2019; Faturës nr. 134 të datës 15.05.2019; Faturës nr. 139 të datës 18.05.2019; Faturës nr. 168 të datës 11.06.2019; Faturës nr. 182 të datës 03.07.2019; Faturës nr. 190 e datës 12.07.2019; Faturës nr.212 të datës 06.08.2019; Faturës nr.220 të datës 17.08.2019; Faturës nr.270 të datës 27.10.2019; Faturës nr.

10 të datës 16.01.2020; Faturës nr.15 të datës 19.01.2020; Faturës nr.104 të datës 08.08.2020; Faturës nr. 115 të datës 29.08.2020; Faturës nr.120 të datës 04.09.2020; Faturës nr. 128 të datës 15.09.2020; Faturës nr.131 të datës 22.09.2020; Faturës nr. 163 të datës 29.10.2020; Faturës nr.185 të datës 20.11.2020; Faturës nr.195 të datës 01.12.2020; Faturës nr.27 të datës 19.02.2021; Faturës nr.55 të datës 23.03.2021; Faturës nr. 112 të datës 21.05.2021; Faturës nr. 126 të datës 03.06.2021; Faturës nr.139 të datës 13.06.2021; Faturës nr. 193 të datës 18.08.2021; duke urdhëruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat e mësipërme brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhrit përmbarimorë t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 2,547.30 € (dy mijë e pesëqind e dyzet e shtatë euro e tridhjetë cent) me kamatëvonesë prej 8%, nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm përmes ndalimit të mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogari bankare dhe përmes regjistrimit, sekuestrimit, vlerësimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri në arkëtimin e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor për shkak se sipas debitorit urdhri përmbarimor është në kundërshtim me ligjin dhe se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar përmbarimi nuk përmban titull ekzekutiv. Tutje, ka kundërshtuar edhe legjitimitetin e palës që ka paraqitur propozimin për përmbarim, me pretendimin se kreditori nuk është palë e autorizuar për të kërkuar përmbushjen e këtij obligimi, me arsyetimin se kreditori është i njëjtë vetëm se ka pasur shndërrim nga B.I. në SH.P.K. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoi prapësimin si të bazuar si dhe të shfuqizojë urdhrin përmbarimor.

Përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor ka ushtruar kreditori, i cili përmes të autorizuarës së tij ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar. Tutje, ka theksuar se ky prapësim ka për qëllim vetëm zvarritjen e procedurës, pasi që sipas kreditorit nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit lidhur me mos pranimin me rregull të faturave pasi që të njëjtat janë pranuar nga debitori dhe janë nënshkruar. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor, si dhe të obligoj debitorin që kreditorit t’ia paguaj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej 104.00 € sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës. Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitur

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1708/22 të datës 30.10.202, ku në pikën e parë të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” me seli në Pejë, dhe ka anuluar pjesërisht Urdhrin P.nr.14/22 i datës 23.02.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Shpend Ahmetaj, sa i përket shumës prej 267.00 € (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro) sipas Faturës nr.182 të datës 03.07.2019; Faturës nr.212 të datës 06.08.2019; Faturës nr.220 të datës 17.08.2019; Faturës nr.15 të datës 19.01.2020 dhe në këtë pjesë procedura përmbartimore është përfunduar. Ndërsa, në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” me seli në Pejë, dhe ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përmbartimor P.nr.14/22 të datës 23.02.2022 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Shpend Ahmetaj për pjesën e detyrimit në shumën prej 2,280.30 € (dy mijë e dyqind e tetëdhjetë euro e tridhjetë cent).

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Urdhri Përmbartimorë P.nr.14/22 i datës 23.02.2022 me të cilin është caktuar përmbartimi në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori në vlerë prej 267.00 € (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro) sipas Faturës nr. 182 të datës 03.07.2019; Faturës nr.212 4 të datës 06.08.2019; Faturës nr.220 të datës 17.08.2019; Faturës nr.15 të datës 19.01.2020; për shkak se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrin për shumën në vlerë prej 2,280.30 € (dy mijë e dyqind e tetëdhjetë euro e tridhjetë cent) për faktin se, Fatura nr.6 të datës 12.01.2019; Fatura nr.23 të datës 08.02.2019; Fatura nr.32 të datës 15.02.2019; Fatura nr.33 të datës 19.02.2019; Fatura nr.48 të datës 06.03.2019; Fatura nr.65 të datës 21.03.2019; Fatura nr.69 të datës 24.03.2019; Fatura nr. 72 të datës 27.03.2019; Fatura nr.108 të datës 27.04.2019; Fatura nr. 109 të datës 27.04.2019; Fatura nr.120 të datës 07.05.2019; Fatura nr. 126 të datës 11.05.2019; Fatura nr. 134 të datës 15.05.2019; Fatura nr. 139 të datës 18.05.2019; Fatura nr. 168 të datës 11.06.2019; Fatura nr. 190 e datës 12.07.2019; Fatura nr.270 të datës 27.10.2019; Fatura nr.10 të datës 16.01.2020; Fatura nr.104 të datës 08.08.2020; Fatura nr. 115 të datës 29.08.2020; Fatura nr.120 të datës 04.09.2020; Fatura nr. 128 të datës 15.09.2020; Fatura nr.131 të datës 22.09.2020; Fatura nr. 163 të datës 29.10.2020; Fatura nr.185

të datës 20.11.2020; Fatura nr.195 të datës 01.12.2020; Fatura nr.27 të datës 19.02.2021; Fatura nr.55 të datës 23.03.2021; Fatura nr. 112 të datës 21.05.2021; Fatura nr. 126 të datës 03.06.2021; Fatura nr.139 të datës 13.06.2021; Fatura nr. 193 të datës 18.08.2021; në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranohet edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbnimore kur në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke shfuqizuar urdhrin përmbnimator P.nr.14/22 i datës 23.02.2022 sa i përket shumës prej 267.00 € ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikim nga shkresat e lëndës konstatohet se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, sa i përket pikës II të dispozitivit vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbnimore kur ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa ka lejuar urdhrin përmbnimator në shumën prej 2,280.30 € ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate konstatohet se përmbnimiti është lejuar në bazë të faturave të lëshuara nga kreditori, të cilat përmbajnë elementet që kërkojnë me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbnim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, e të cilat janë të pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori gjegjësisht të nënshkruara nga ana e debitorit, dhe se nga shkresat e lëndës nuk rezulton se debitori faturat në fjalë i kundërshtuar në afat ligjor. Andaj, Gjykata e shkallës

së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykate i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore të debitorit, lidhur me at se faturave nuk i janë bashkangjitur kuponat fiskal, por të njëjta mbesin të pabazuara pasi që debitori ka pranuar faturat në fjale dhe se nuk ka ofruar asnjë provë me të cilat do të vërtetohet se i ka kundërshtuar të njëjta në afatin ligjor. Po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore lidhur me nënshkrimin e faturave, por të njëjtat pretendime janë vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë dhe për të cilat ka dhënë sqarime të mjaftushme për të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj pretendimet ankimore nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore pasi që nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj edhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formal të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Andaj, nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur me këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit e pathemeltë.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.37/24 me datë 24.05.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija- Ymeri